



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 250/1 Prot.

Tiranë, më 13.02.2018

V E N D I M

Nr. 5, datë 13.02.2018

**MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT TË MARRË
NËPËRMJET KËRKESËS SË PUNONJËSIT ***** , PROTOKOLLUAR ME NR.
1714/3 PROT., DATË 23.11.2017**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Me anën e kërkesës/informacionit të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 1714/3 prot., datë 23.11.2017, nëpunësi ***** , me detyrë “Inspektor - Ekspert”, në Sektorin e Ekzaminimeve Biologjike dhe ADN, në Institutin e Policisë Shkencore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka ngritur pretendimin se është larguar nga funksionet e Policisë së Shtetit, me Urdhrin nr. 1968, datë 16.10.2017, “Për largimin nga funksionet ndihmëse të Policisë së Shtetit të një punonjësi me statusin e nëpunësit civil”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pa zbatuar procedurat e detyrueshme për lirim nga shërbimi civil, të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet shkresës me nr. 1714 prot., datë 23.10.2017, të dërguar nga punonjësi në fjalë, ka rënë në dijeni të faktit se ai, i është drejtuar Komisionit të Apelit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me ankim

administrativ, në lidhje me largimin e tij nga detyra. Ky organizëm shqyrton ankesat e punonjësve të policisë së shtetit.

Me shkresat nr. 1714/1 prot., datë 27.10.2017, “*Kërkohet informacion lidhur me punonjës *****” dhe nr. 1714/5 prot., datë 1.12.2017, “*Mbi verifikimin paraprak të informacionit*”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga ana e Komisionerit u kërkuar materialet shkresore që pasqyrojnë realizimin e veprimeve administrative të kryera për lirin nga shërbimi civil të punonjësit ****, si dhe çdo akt tjetër që ka lidhje me këtë procedurë.

Në përgjigje të kërkesës më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresat nr.939/3 prot., datë 17.11.2017, “*Informacion mbi një shtetas*” dhe nr. 939/6 prot., datë 12.12.2017, “*Kthim përgjigje*”, ka dërguar pranë Komisionerit aktin nr. 1491/172 prot., datë 30.10.2014, “*Akti i deklaramentit të statusit të punësimit*”, të Departamentit të Administratës Publike; aktin nr. 8839 prot., datë 14.9.2017, “*Refuzohet pajisja me CSP për *****”, të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe Urdhrin nr. 1968, datë 16.10.2017, “*Për largimin nga funksionet ndihmëse të Policisë së Shtetit të një punonjësi me statusin e nëpunësit civil*”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Nga analiza e materialeve shkresore të dërguara nga institucioni, si dhe materialeve bashkëlidhur kërkesës/informacionit të paraqitur nga nëpunësi, rezultoi se,

Nëpunësi ****, ka filluar punë që prej vitit 2007 në Laboratorin e Policisë Shkencore, sot Instituti i Policisë Shkencore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në detyrën “*Inspektor-Ekspert*”, në Sektorin e Ekzaminimeve Biologjike dhe ADN.

Me aktin nr. 1491/172 prot., datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, punonjësi në fjalë është deklaruar nëpunës civil në pozicionin Inspektor Ekspert, në Sektorin e Shkencave Ligjore, në Drejtorinë e Policisë Shkencore, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Nga verifikimi i mëtejshëm i akteve, konstatohet se, me Urdhrin nr. 1968, datë 16.10.2017, “*Për largimin nga funksionet ndihmëse të Policisë së Shtetit të një punonjësi me statusin e nëpunësit civil*”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ky nëpunës është liruar nga detyra.

Duke analizuar përmbajtjen e aktit të Drejtorit të Përgjithshëm për lirin nga detyra, rezulton se shkak për këtë veprim administrativ, ka shërbyer shkresa nr. 8839 prot., datë 14.9.2017, “*Refuzohet pajisja me CSP për *****”, e Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe si referencë ligjore, ligji nr. 108/2014, “*Për policinë e shtetit*”.

Në materialet e administruara gjatë hetimit administrativ, konstatohet se, sipas Urdhrit të Brendshëm nr. 273, datë 28.5.2015, të Ministrit të Brendshëm, pozicionet e punës në Drejtorinë e Policisë Shkencore, aktualisht Instituti i Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për vetë natyrën specifike të punës që kryejnë, kërkojnë Çertifikatën e Sigurimit të Personelit.

Kjo kërkesë, është pasqyruar edhe në përshkrimet e punës të hartuara për këto pozicione, ku në kriteret e posaçme, krahas arsimit dhe kualifikimeve që duhet të ketë punonjësi, duhet të jetë i pajisur dhe me CSP.

Për sa më sipër, institucioni ka ngritur pretendimin se duke qenë në kushtet kur, nëpunësi nuk plotëson një nga kriteret thelbësore që kërkon pozicioni i punës, që është Çertifikata e Sigurimit të Personelit dhe kur në Policinë e Shtetit nuk ka asnjë pozicion pune që të plotësojë njëkohësisht të dy kushtet,

a) arsimin e nëpunësit *****,

b) të mos njihet me informacion të klasifikuar, e për pasojë, nuk ka mundësi që të sistemojë në punë këtë punonjës.

Nga përmbajtja e akteve që materializojnë këtë veprim administrativ të institucionit, për lirim nga detyra të punonjësit, e vlerësuar në raport me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, rezulton se, procedura, nuk është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 66, të ligjit, si dhe pikës 21, Kreu III, të Vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”.

Në rastin konkret, procedura për lirim nga detyra, ka filluar pas marrjes së njoftimit nga DSIK-ja, për mos pajisjen me Çertifikatën e Sigurimit të Personelit të nëpunësit ***** dhe në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr. 273, datë 28.5.2015, të Ministrit të Brendshëm, punonjësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në këtë institucion me aktin e nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, duke mos respektuar procedurën për lirim nga shërbimi civil.

Theksojmë se, për rastin në fjalë, është njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën, që ka detyrimin të ndërmarrë veprimet ligjore për lirim nga shërbimi civil të nëpunësit.

Nga dokumentacioni shkresor i vënë në dispozicion prej institucionit, rezulton se njësia e burimeve njerëzore, nuk ka kryer asnjë veprim në respektim të kërkesave të nenit 66, pika 4/a, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

“ 4. Lirimi deklarohet me vendim të:

a) njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën”.

Në vijim, përcaktohet detyrimi që të njoftohet Departamenti i Administratës Publike, për vendimin e lirit të nëpunësit, ç'ka rrjedh nga kërkesat e pikës 21, të Kreut III, të vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, në të cilin parashikohet se, “në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, njësia e burimeve njerëzore njofton DAP-in për vendimin e lirit nga shërbimi civil të nëpunësve të kategorisë ekzekutive, të ulët apo të mesme drejtuese, brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit.”

Nga përmbajtja e materialeve shkresore të analizuara më sipër, nuk provohet që njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të ketë kryer procedurën ligjore për lirim nga shërbimi civil. Në këto kushte, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 1774/4 prot., datë 30.11.2017, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, si njësia përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil për institucionet e administratës shtetërore, ka kërkuar informacion në lidhje me procedurën e kryer për rastin në fjalë.

Në përgjigjen e Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 6774/1, datë 27.12.2017, Komisioneri informohet se: “..... në mbështetje të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, (DAP) nuk ka ndërmarrë asnjë procedurë për lirim nga shërbimi civil të ***** , me detyrë Inspektor-Ekspert në Sektorin e Ekzaminimeve Biologjike dhe ADN, në Institutin e Policisë Shkencore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

Gjithashtu, nga hetimi administrativ rezultoi se nëpunësi ***** , i është drejtuar DAP me kërkesën me objekt, “Për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me Urdhrin nr. 1986, dt. 24.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”, në përgjigje të së cilës, DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke kërkuar të shqyrtojë rastin e këtij punonjësi, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun XII, “Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe legjislacionin e posaçëm për informacionin e klasifikuar (dokumentacioni administrohet në dosje). Gjithashtu, DAP, kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, që pas kryerjes së veprimeve të mësipërme të informohet prej tyre.

Nisur nga sa analizuam më sipër, si dhe nga përmbajtja e akteve ligjore e nënligjore, në të cilat materializohet mënyra e procedimit për lirim nga shërbimi civil, provohet se nga institucioni (njësia e burimeve njerëzore), nga pikëpamja procedurale, nuk janë respektuar kërkesat e ligjit që kanë të bëjnë me:

- ✓ momentin e konstatimit të shkakut për lirim nga shërbimi civil,
- ✓ deklarin me vendim për lirim nga shërbimi civil nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën,

- ✓ njoftimin e DAP-it për vendimin e marrë nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, për lirimin e nëpunësit nga shërbimi civil.

Vërejmë se procedura për lirimin nga shërbimi civil në këtë rast, nuk është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 66, pika 4/a, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe pikës 21, të Kreut III, të vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, si dhe akti i lirimimit ka dalë në kapërcim të kompetencave ligjore nga Drejtoria i Përgjithshëm i Policisë.

Në këto rrethana, nga ana e institucionit, duhet të rifillojë procedura e lirimimit nga shërbimi civil, me qëllim që të kryhet në përputhje me rregullimet ligjore që u përmendën në pjesën e mësipërme të këtij vendimi.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” e nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Drejtoria i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, që të rivendosë ligjshmërinë në këtë rast, duke konstatuar menjëherë pavlefshmërinë absolute të Urdhrit nr. 1968, datë 16.10.2017, për lirimin nga funksionet ndihmëse të Policisë së Shtetit të punonjësit *****, emëruar në pozicionin e punës, “Inspektor-Ekspert në Sektorin e Ekzaminimeve Biologjike dhe ADN, në Institutin e Policisë Shkencore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, pasi akti ka dalë në tejkalim të kompetencave ligjore të titullarit të institucionit, si dhe duke mos zbatuar procedurën e nxjerrjes së aktit.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën, të rregullojë pasojat duke e kryer procedurën në përputhje me rregullimet ligjore, sipas këtij rendi:
 - ✓ Të deklarojë me vendim lirimin nga shërbimi civil të punonjësit *****, duke përcaktuar qartë shkakun për lirimin nga shërbimi civil.
 - ✓ Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për vendimin e marrë nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, për këtë rast.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

4. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **10** ditë.
5. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha